

UDHËZIM
Nr.2324, datë 5.12.2008

**MBI NJË NDRYSHIM TË UDHËZIMIT NR.203, DATË 1.2.2007 NË ZBATIM TË
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.873, DATË 27.12.2006 “PËR
MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË
PROGRAMEVE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E
PAPUNË, QË KANË MBARUAR ARSIMIN E LARTË, BREND APO JASHTË
VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.203, datë 1.2.2007 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, bëhet ndryshim si më poshtë vijon:

Në nenin 1 togfjalëshi “datës 1 prill 2007” të zëvendësohet me togfjalëshin “çdo fillim viti”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA**
Anastas Duro